

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kuvendi miraton deklaratën për aktgjykimin e Speciales
ADRESA	https://www.koha.net/lajmet-e-mbremjes-ktv/aktgjykimi-i-speciales-ben-bashke-deputetet
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 01:50:42 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 17:11:06 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a2f7c1f74dd17c414cbf638553f9df90df0a93ad4779b2261e5b9cafde8373af
TEKSTI	3cb3d3772f14c4d9aa64ef74ed8443c83422f2a36399f13033b7186654f5aa54
PAMJA	7a01cc9efce25c9bd02910c23ec7d0135442b1858d3d312584a7dd932ccb4b62

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5ba9478498f23caba2292abac81ff4aaa53f25f79e6ecc26c4ba0ba9f9ec70df
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5ba9478498f23caba2292abac81ff4aaa53f25f79e6ecc26c4ba0ba9f9ec70df>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

LAJMET E MBRËMJES

Kuvendi miraton deklaratën për aktgjykimin e Speciales



Foto: Driton Paçarada

Nga: Rrezon Gashi

28 shtator 2026 19:11

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalën tonë zyrtar në Viber

Deklarata e votuar nga 99 deputetë shpreh shqetësimin ndaj aktgjykimit të shkallës së parë kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Në deklaratë vlerësohet i papranueshëm konstatimin i Dhomave të Specializuara për ekzistencën e një qëllimi të përbashkët kriminal, ndërsa në njërin nga shtatë pikat e saj bëhet edhe thirrje për hartimin e një strategjie të përbashkët shtetërore në kuadër të së cilës të bashkërendohen veprimet juridike, institucionale dhe diplomatike. Deklarata si kjo e së hënës nuk prodhon efekte juridike të detyrueshme

Kuvendi i Kosovës me 99 vota e ka miratuar Deklaratën për aktgjykimin e Dhomave të Specializuara në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit.

Deklarata mes tjerash e konsideron të papranueshëm konstatimi për ekzistencën e një qëllimi të përbashkët kriminal nga të katër të dënuarit nga shkalla e parë. Teksti gjithashtu kërkon që Gjykata Speciale të mos dalë nga mandati i saj dhe konstaton që ka ekzistuar Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale për dëbimin e shqiptarëve nga Kosova, e zbatuar përmes aparatit shtetëror, ushtarak dhe policorë jugosllav e serb.

Deklaratën shtatëpikëshe, ku është përfshirë edhe një kërkesë për institucionet shtetërore e lexoi para deputetëve, kryetarja e Kuvendit, Albulena Haxhiu.

“Kërkon nga të gjitha institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për mbrojtjen e së vërtetës dhe të pastërtisë së luftës çlirimtare të popullit të Kosovës. Kuvendi bën thirrje për hartimin e një strategjie të përbashkët shtetërore, në kuadër të së cilës të bashkërendohen veprimet juridike, institucionale dhe diplomatike.

Arbëri.

Jakaj: PDK-ja kalkuloi me afate në Deklaratë, sepse do t'i duhej ta votonte presidentin

Futboll.

Tifozët e Turqisë kërkojnë largimin e Vincenzo Montellës

Futboll.

Supergoli i Olises ia siguron Francës fitoren e dytë

Futboll.

Zeneli titullar në fitoren e dytë të Suedisë

Futboll.

Bosnjë-Hercegovina e mposht thellë Rumaninë në Bukuresht

Showbiz.

Rita Ora kalon testin e vozitjes

diplomatiqe per mbrojtjen dhe atirumimin e se vertetes se piote historike mbi luftën e drejtë për liri dhe çlirim të Kosovës”, thuhet në deklaratën e lexuar nga Haxhiu.

Seanca ka nisur me një orë vonesë. Dhe ishte Haxhiu që foli për arsyet e vonesës dhe për procesin që ka qar në dakordimin e subjekteve politike.

Edhe



Arbëri • 14 o. më parë

Kuvendi miraton deklaratën për aktgjykimin e Speciales

“Gjatë këtyre ditëve ka pasur takime të vazhdueshme në mes të përfaqësuesve të Grupeve Parlamentare, sidomos sot, prandaj edhe këtë seancë e kemi nisur me vonesë. Prandaj ne tashmë kemi një draft të dakorduar nga të gjitha Grupet Parlamentare - Lëvizja Vetëvendosje, PDK-ja, LDK-ja dhe Grupi Multietnik”, ka thënë Haxhiu.

Deklarata e cila nuk prodhon efekte juridike të detyrueshme mori votat e 99 deputetëve. Në seancën munguan ligjvënësit e Listës Serbe.

Deputetja e LDK-së, Jehona Lushaku-Sadriu ka thënë se e vlerëson përfshirjen e të gjitha komenteve të partive politike në deklaratë.

“Dëshirojmë të kontribuojmë që Kosova të jetë shtet i pavarur dhe me liri. Të funksionojë në institucionet e saj të pavarura. Është e rëndësishme që të jemi në ballë të detyrës”, ka thënë ajo.

Për ndryshim-plotësimin e ligjit për Dhomat e Specializuara, të propozuar nga PDK-ja, ajo ka thënë se duhen shikuar të gjitha procedurat ligjore.

E Partia Demokratike e Kosovës, e cila kishte sponsorizuar këtë deklaratë, e ka përshëndetur miratimin e saj në Kuvend. Përmes një deklarate për media, PDK-ja ka falënderuar grupet parlamentare, derisa ka deklaruar se radha është e projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara të cilin e kanë propozuar javën e kaluar.

“Kërkojmë nga Qeveria që ta procedojë pa vonesë në Kuvend dhe nga të gjitha grupet parlamentare që ta trajtojnë e votojnë me urgjencë”, thuhet në deklaratë e kësaj partie.

Në dokumentin për ndryshimet e propozuara në Ligjin për Specialen që është dërguar në Qeveri nga PDK-ja, argumentohet nevoja e ndërhyrjeve në ligj pas vendimit të 16 shtatorit ku UÇK-ja u kualifikua si ndërmarrje e përbashkët kriminale. Sipas dokumentit, Gjykata Speciale u themelua me mendimin se një trup gjykues do të trajtonte pretendimet specifike të përgjegjësisë penale individuale.

Në propozimin e PDK-së kërkohet që të ngushtohet mandati ligjor i Gjykatës Speciale vetëm në veprat penale të përcaktuara në Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës të 7 janarit 2011. Po ashtu, kërkohet që të ndryshohet edhe neni që ka të bëjë me dënimet maksimale, duke e kufizuar në 15 vjet burgim. Vuajtja e dënimeve, sipas ndryshimeve, kërkohet që të bëhet në institucionet korrektuese të Kosovës, ndërsa që personat e dënuar nga Gjykata Speciale me vendim të formës së prerë të kenë mundësinë të jenë subjekt i faljes nga presidenti i Kosovës.

Edhe



Arbëri • 13 o. më parë

PDK-ja përshëndet miratimin e Deklaratës: Të votohen edhe plotësim-ndryshimet e Ligjit për Specialen

Një prej ndryshimeve që kërkohet të bëhet në ligj është edhe koha e hetimeve që mbulon Gjykata Speciale. Në të kërkohet që të jetë nga 1 korriku 1999 deri më 31 dhjetor 2000 – teksa në ligjin aktual periudha e hetimeve të krimeve të pretenduara të kryera nga ish-anëtarët e UÇK-së është nga janari 1998 deri në dhjetor 2000.

Po ashtu, kërkohen ndryshimet edhe sa i përket juridiksionit

territorial, duke e kufizuar në veprat që mund të jenë kryer brenda territorit të Kosovës. Zyra e Prokurorit të Specializuar ka hetuar dhe për krime që pretendohet se janë kryer edhe në veri të Shqipërisë.

Po ashtu kërkohet që gjykimet e pushuara dhe aktakuzat e konfirmuara të transferohen në Departamentin Special të Gjykatës Themelore, të Apelit dhe Supremes në Prishtinë, ndërkaq hetimet dhe dosjet parapake të transferohen në Prokurorinë Speciale të Kosovës në Prishtinë.

Dhomat e Specializuara në Hagë, me nga 25 vjet burgim i dënuan ish-presidentin e Kosovës e liderin e PDK-së, Hashim Thaçi dhe ish-kryetarin e Kuvendit, Jakup Krasniqi. Me 18 vjet burgim u dënua ish-kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, ndërsa me 13 vjet ish-shefi i Grupit Parlamentar të LVV-së, Rexhep Selimi. Të katër të dënuarit, që mbanin poste drejtuese në UÇK, janë akuzuar për krime lufte në vitet 1998-99, ndërsa e liruan atë nga akuzat për krime kundër njerëzimit. Aktgjykimi i 16 shtatorit nuk është i formës së prerë dhe mund të apelohe.

Në seancën e së hënës përpos deklaratës, pati edhe tri pika të tjera të rendit të ditës.

U miratuan procesverbalet nga seancat konstituive, u betuan deputetët e rinj që morën ulëset, pasi ato u liruan nga kolegët e tyre që u përfshinë në ekzekutiv, dhe u formuan komisionet parlamentare.

Gjithashtu u votua edhe Vlora Çitaku si nënkryetare e kuvendit. Nënkryetari i propozuar nga PDK-ja ishte i vetmi që nuk ishte zgjedhur në seancën e kaluar. Kjo pasi PDK-ja i ishte drejtuar Gjykatës Kushtetuese për vlerësim nëse konstituimi i Kuvendit pas afateve ishte i ligjshëm.

Javën e kaluar Kushtetuesja vlerësoi se Kuvendi është i konstituuar e po ashtu kushtetues ajo e vlerësoi edhe formimin e Qeverisë së re.

Betohen deputetët e rinj

Në seancën e mbajtur të hënën Kuvendi gjithashtu ka formuar 16 komisione parlamentare dhe janë betuar deputetët e rinj, që në të vërtetë janë “zëvendësim” i deputetëve që janë bërë pjesë e kabinetit të Qeverisë Kurti.

Edhe

Arbëri • 14 s. më parë

Teksti i plotë i Deklaratës së Kuvendit të Kosovës për vendimin e Speciales

Deputetët e betuar janë:

- Naim Bardiqi zëvendëson Albin Kurtin
- Fitim Haziri zëvendëson Glauk Konjufcën
- Ilir Qeriqi zëvendëson Hekuran Muratin
- Egzon Azemi zëvendëson Donika Gërvallën
- Mimoza Shala zëvendëson Xhelal Sveçlën
- Arsim Ademi zëvendëson Ejup Maqedoncin
- Luan Aliu zëvendëson Hajrullah Çekun
- Fatos Geci zëvendëson Mimoza Kusari-Lila
- Adelina Tërshana zëvendëson Andin Hotin
- Ejup Ahmeti zëvendëson Arben Vitinë
- Filiz Mustafa zëvendëson Saranda Bogujevcin
- Arjeta Rexhepi zëvendëson Armend Mujën
- Fahrush Rexhepi zëvendëson Artane Rizvanollin
- Elvira Ibrahimiri -Hoti zëvendëson Dimal Bashën
- Bylbyl Sokoli zëvendëson Agon Batushën
- Ergyl Mazrek zëvendëson Fikrim Damkën
- Fridon Lala zëvendëson Elbert Krasniqin
- Lazar Radulović zëvendëson Nenad Rashiqin
- Bahrim Shabani zëvendëson Rasim Demirin

#KUVENDI I KOSOVES

#GJYKATA SPECIALE NE HAGE

Artikuj të ngjashëm

Arbëri • 18 s. më parë

Kuvendi pritet të dalë me deklaratë kundër
dënimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësisë që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatesisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzim për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatesisë dhe cookies

Perkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh
Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS